



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e76-të, të mbajtur më 25.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-72598/1 i datës 20.21.2021, HIDHET POSHT.
KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-7259 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-7259/1 të datës 20.07.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Në denoncim ka dyshime për punësim të paligjshëm të personit zyrtarë në ///, i cili ka dhënë informacion të pasaktë për kombësinë e tij. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas inspektimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja konstatoi se tashmë kishte vepruar sipas një denoncimi me pretendime të ngjashme nr. 3328/1, datë 24.06.2019, për të cilin në vazhdimin e parë të seancës së 55-të të mbajtur më 17.11.2021, ka miratuar vendimin nr. 12-3069/7 datë 17.12.2021. Prandaj, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: G.T.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska

